



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

**Nr. 2 datë 22.1.2020**

**“PËR MIRATIMIN E NGRITJES, PËRBËRJES DHE FUNKSIONIMIT TË  
KOMISIONIT TË STREHIMIT“**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 22.1.2020, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 8, nenit 24 pika 2, të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore“, i ndryshuar; nenit 2 pika 51, të ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social“, VKM nr.384 datë 12.06.2019 “Për caktimin e dokumentacionit për të përfutur sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore“, me 27 vota pro,

**V E N D O S I:**

1. Ngritjen e Komisionit të Strehimit.
2. Miratimin e përbërjes së komisionit të strehimit, si më poshtë:
  - Kryetar: N/Kryetari i Bashkisë;
  - N/Kryetar: Përfaqësues nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik;
  - Anëtar: Përfaqësues nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik;
  - Anëtar: Përfaqësues, Drejtoria e Analizës dhe Programit Buxhetor;
  - Anëtar: Përfaqësues Drejtoria Juridike;
  - Anëtar: Përfaqësues, Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, PAN;
  - Anëtar: Përfaqësues, Drejtoria e Kontrollit dhe e Zhvillimit të Territorit ose Drejtoria e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve;
  - Anëtar: Përfaqësues të shoqatave të jetimëve;
  - Anëtar: Përfaqësues të shoqatave në mbrojtje të grave;
  - Anëtar: Përfaqësues të shoqatave në mbrojtje të PAN;

- Anëtar: Përfaqësues të të persekutuarëve politik;
  - Anëtar: Përfaqësues të komunitetit, shoqatave në mbrojtje të të drejtave të minoriteteve romë dhe egjiptiane;
  - Anëtar: Përfaqësues të shoqatave në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve.
3. Funksionimin e Komisionit të Strehimit sipas kuadrit ligjor që rregullon fushën e strehimit social.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

**Sekretar i Këshillit**



**Denis Llesha**

**KRYETARE**

